

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Ishte tronditëse video-audioja e “21 janarit” të vitit 2011. Kolegët e opozitës që qeshin në mënyrën më sarkastike me ato që ne dëgjuam dje dhe qarkulluan nëpër media, zëri, videoja dhe imazhi i asaj që ka ndodhur 12 vjet më parë. Si mund të qeshet, vetëm ju e dini, ju qofshi! Ia lë Zotit t’ju gjykojë, ndërkohë që presim që drejtësia të gjykojë! E shkuara nuk ka vdekur, - thotë William Faulkner, - madje ajo as ka kaluar. Mirë është që ndonjëherë t’i dëgjojmë këta shkrimtarët e mëdhenj dhe besoj se ata që i kanë lexuar romanet e tij, më kuptojnë. Është e rëndësishme të rikthehemi edhe 12 vjet më pas. Janë gati 2 breza në këta 12 vjet që nuk e kanë ndierë, madje nuk e kanë parë, nuk e kanë provuar në kurriz jo e jo, atë që ndodhi atë ditë tragjike për historinë e demokracisë shqiptare, që edhe kështu është mjaft e brishtë. Ndaj, kush e solli në vëmendje të publikut këto ditë atë dëshmi, i ka bërë një shërbim të madh demokracisë, i ka bërë një shërbim të madh kujtesës, i ka bërë një shërbim të madh publikut, sidomos drejtësisë (shpresoj shumë), por edhe së ardhmes. Reagimi juaj skandaloz tani, me atë të qeshur, flet shumë më tepër, në fakt, sesa çdolloj komenti që do të bënin të gjithë politikanët bashkë! Megjithatë, meqenëse ju vjen për të qeshur, po jua rikujtoj transkriptin. Do ta lexoj patjetër, sepse e shkuara nuk ka vdekur, madje ajo as që ka kaluar: “Gati armët luftarake”. Keni gjak në duar. Të bëni sa të doni mocione, historia mbetet aty. “Zjarr luftarak për t’i asgjësuar! Gati për zjarr e, kur të them unë, bjeri në trup!”. “Bjeri në trup” duket si përçudnim i fantazisë, por, në fakt, nuk është as më shumë e as më pak, por për të zezën tonë, për të zezën e demokracisë, për faqen e zezë të drejtësisë dhe të institucioneve shqiptare, ky urdhër, që doni të bëni sikur e keni harruar, por është aty, është realitet me zë dhe me figurë. Nëse kjo ju bën për të qeshur, është midis makabres dhe kriminalitetit.

Si mund të flisni ju për histori me zyrtarë të FBI-së, me Kryeministrin shqiptar, ndërkohë që po përpiqeni ta mbani këtë histori me thonj, me mish e me shpirt, mbi sofrën mediatike?! Sa hall i madh ju ka zënë; hall i madh mes jush, hall i madh me veten tuaj, hall i madh me lidhshypin tuaj të bërë fije-fije! Doli një histori dhe u pamë për të bërë mocion me debat! Meqenëse kolegu para meje foli për agjencitë ligjzbatuese, si nuk thatë një fjalë në këta 12 vjet për atë që ndodhi, për atë që dje na e risollën në vëmendje gazetarët dhe mediet?! Nuk thatë një fjalë as ju të vulës dhe as ju të foltores, për plagën ende të hapur sot të shoqërisë shqiptare; dogjë të plumbin e shkrirë të bizneseve të pista shtetërore të “Gërdecit” 26 viktima të pafajshme, që ende s’i tret dheu, se drejtësi ende nuk është bërë! Nuk ju mjaftoi kjo masakër dhe, si për të rrumbullakosur kriminalisht atë shifër të jetëve të marra, në biznesin e familjes ish-kryeministore ngritët armën shtetërore. “Drejt e mbi trupa, - citoj këtu ish-komandantin e Gardës, - në shpinë, në kokë, në gjoks”. Një burrë, një vëlla, një baba e një shok! Më pas, jo vetëm që nuk pati pendim, reflektim, ndëshkim jo e jo, por lëshuat stuhitë e pështymave, të baltës e plehrave mbi ish-Prokuroren e Përgjithshme, që vetë e zgjodhët, vetëm se guxoi dhe tentoi të bënte detyrën në bazë të ligjit, që, në fakt, nuk e latë ta bënte, meqë po flasim për agjencitë ligjzbatuese. Është çmenduria më e madhe institucionale e historisë së demokracisë, që sot duket e vështirë të përfytyrohet, ndërsa kjo mazhorancë konceptoi, ndërtoi dhe realizoi reformën historike të drejtësisë, dhe ende ka shumë për të bërë. Por kjo tregon se sa i madh është hendeku mes jush dhe mes nesh, që nga momenti kur ju vazhdoni të qeshni në mënyrën më të paturpshme edhe 12 vjet më pas, kur media risjell dëshmi të fshehura të asaj që ndodhi, dhe, kur vjen puna për seriozitetin që doni t’i jepni drejtësisë, kjo nuk ka nevojë për koment! Çfarë i thatë kreut të drejtësisë, kreut të organit të akuzës? E quajtët të paafët profesionalisht, intriguere kulisash, komplotiste në

çadra pistoletë, puçiste me stilolapsa helmues, lavire bulevardi e të tjera, dhe sot guxoni e flisni, duke kërkuar të bëhet drejtësi për një histori që gjykohet në SHBA! Do të presim të gjykohet, pa diskutim, me besimin më të madh që kemi për atë vend, që është aleati ynë kryesor. Ja ku jemi sot, pasi kjo mazhorancë është votuar 3 herë nga shqiptarët, pasi historia ka treguar se partnerët tanë strategjikë dhe mbështetësit e kombit shqiptar e kanë thënë me zë dhe me figurë se cilët janë armiqtë e SHBA-ve me pasaportë shqiptare, se kush është armiku i demokracisë, dhe, përderisa i konsiderojmë partnerë strategjikë, duhet t'i dëgjojmë në të gjitha gjërat që thonë. Ne vazhdojmë në këtë sallë të përkthejmë së prapthi tekstin e procesit të zyrtarit të FBI-së, të nisur në SHBA, që do të gjykohet në SHBA dhe do ta dëgjojmë nga SHBA-të. Përkthimin e saktë e dëgjuat sot nga Kryeministri i Shqipërisë. Nuk e mbani mend? Merreni dhe dëgjojeni sërish! Ama, po përkthimin e urdhrave vrasës për zjarr luftarak në trupat e shqiptarëve, nga ish-pushteti i foltores, kush do ta bëjë? Pse ende sot nuk kemi një proces të drejtë për të mbyllur plagët tona të hapura? Si nuk doli ndonjë prej jush ta bëjë këtë pyetje dhe të bëjë edhe një mocion me debat, pa debat, me pyetje apo me interpelancë? Ejani ta bëjmë! Drejtësia në reformim ka ende punë të madhe për të bërë. "Drejtësia është më e mirë sesa ishte, por ende ka rrugë të gjatë për të bërë", - tha kolegu pak më parë, dhe e falënderoj! Nuk do të rreshtim së kërkuari derisa të bëhet drejtësi, ndërkohë do të vijojmë punën me njerëzit, për njerëzit, por edhe për të ndjekur agjendën tonë elektorale, që ka një datë të shënuar më 14 maj të këtij viti, ku do të japim llogari, por edhe ku do të marrim votëbesim, sepse për Partinë Socialiste agjenda e njerëzve është shumë më e rëndësishme (ndaj po e bëjmë çdo ditë) sesa qeshjet tuaja cinike.